



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 19 prot.

Tiranë, më 05.01.2026

URDHËR

Nr. 1, datë 05.01.2026

PËR

**MIRATIMIN E FORMATIT TË RAPORTIMIT TË AUTORITETEVE
PUBLIKE MBI ZBATIMIN E KËRKESAVE TË LIGJIT PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT PËR VITIN 2025**

Në mbështetje të nenit 24/1 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formatit të raportimit të autoriteteve publike për vitin 2025, bashkëlidhur këtij urdhëri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Të gjitha autoritetet publike janë përgjegjëse për raportimin e saktë të të dhënave dhe dërgimin e raportit brenda datës 31 janar 2026.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit për dërgimin e formatit të raportimit të gjitha autoriteteve publike, mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe publikimin e tyre.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

RAPORTIMI I TË DHËNAVE NGA AUTORITETET PUBLIKE MBI ZBATIMIN E DISPOZITAVE TË LIGJIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT PËR VITIN 2025

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e të drejtës së informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, për garantimin, respektimin dhe ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në përputhje me nenin 24/1 “Detyrimi për bashkëpunim” të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”):

1. *Autoritetet publike bashkëpunojnë me Komisionerin duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave.*
2. *Autoritetet publike raportojnë çdo vit, jo më vonë se data 31 e muajit janar të vitit pasardhës, pranë Komisionerit lidhur me veprimtarinë për zbatimin e kërkesave të këtij ligji, sipas formatit të miratuar nga Komisioneri”.*

Ky përcaktim ligjor i shërben funksionit kontrollues që Komisioneri ushtron mbi autoritetet publike, evidentimit të problematikave në zbatimin e ligjit, si dhe rritjes së përgjegjshmërisë e llogaridhënies së tyre përballë publikut, grupeve të interesit apo medias. Bashkëpunimi i autoriteteve publike me Zyrën e Komisionerit përbën një nga aspektet më të rëndësishme në drejtim të garantimit praktik të së drejtës për informim dhe përmbushjen e qëllimit të LDI. Plotësimi i këtij pyetësori me të dhëna të sakta dhe të përditësuara është një detyrim për çdo titullar të autoriteteve publike, apo çdo personi përgjegjës, në mënyrë që të vihet në dispozicion i gjithë informacioni i domosdoshëm për Komisionerin në funksion të ushtrimit përmbushjes së kompetencave të tij ligjore.

Periudha raportuese është janar-dhjetor 2025 dhe pyetësori i plotësuar i dërgohet në rrugë zyrtare dhe/ose elektronike Zyrës së Komisionerit brenda datës 31 janar të vitit 2026. Të dhënat që mblidhen nga ky pyetësor janë të dhëna publike dhe përbëjnë informacion publik sipas LDI dhe ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdoirmin e informacionit të sektorit publik” dhe publikohen në formën/formatin që i raportohen Zyrës së Komisionerit. Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit do të publikohen/përditësohen dhe në portalin *pyetshtetin.al* dhe do të qëndrojnë aq kohë sa do të ushtrohet kompetenca e koordinatorit për të drejtën e informimit.

PYETËSORI

1. Emërtesa e plotë e autoritetit publik:

(me gërma kapitale)

2. A ka autoriteti publik një faqe zyrtare të internetit?

Po ☐Jo ☐

3. Nëse keni një faqe zyrtare të internetit, ju lutem vendosni lidhjen përkatëse (link):

[illegible]

3.1 Nëse nuk keni faqe zyrtare interneti, deklaroni arsyen/et e mospasjes së saj:

4. A është i publikuar/përditësuar Programi i Transparencës i autoritetit publik?

Po ☐Jo ☐

5. Cili është personi përgjegjës (specifikoni vetëm rolin/funksionin: psh. titullari/sekretar i përgjithshëm) në autoritetin publik për vënien në zbatim, rishikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës, sipas detyrimeve ligjore që burojnë nga nenet 18 dhe 19 të LDI?

5.1 Në rast delegimi të kompetencës së ushtrimit të funksioneve (sipas pikës 2 të nenit 19 të LDI) bashkëlidhni aktin e delegimit:

6. A është caktuar një koordinator për të drejtën e informimit në autoritetin publik?

Po $\square$

Jo ☐

7. Nëse po, plotësoni të dhënat e tij:

Emër:

Mbiemër:

[illegible]

Adresa e postës elektronike:

[illegible]

Nr. telefon i zyrës:

[illegible]

Nr. telefon cel.:

[illegible]

8. Koordinator mban, publikon dhe përditëson çdo muaj në faqen zyrtare “Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve”, sipas formatit¹ të miratuar nga Komisioneri?

Po ☐

Jo ☐

9. Sa kërkesa për informacion publik në total janë regjistruar në Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve nga koordinatori për të drejtën e informimit për periudhën janar-dhjetor 2025?

(shënoni numrin)

10. Sa nga këto kërkesa:

a. kanë marrë përgjigje të plotë:

(shënoni numrin)

b. kanë marrë përgjigje të pjesshme (të kufizuar sipas nenit 17 të LDI):

(shënoni numrin)

c. janë refuzuar:

(shënoni numrin)

d. janë deleguar pranë një autoriteti tjetër:

(shënoni numrin)

¹ https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Urdher_nr.188.pdf

11. Nëse përgjigja është dhënë e pjesshme ose është refuzuar në bazë të nenit 17 të LDI, zgjidhni arsyen e kufizimit/refuzimit të dhënies së informacionit/dokumentacionit:

i.e drejta për një jetë private:

(shënoni numrin)

ii.sekreti tregtar:

(shënoni numrin)

iii.e drejta e autorit:

(shënoni numrin)

iv.patenta/t:

(shënoni numrin)

v.siguria kombëtare:

(shënoni numrin)

vi.parandalimi, hetimi dhe ndjekjen e veprave penale:

(shënoni numrin)

vii.mbarëvajtja e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor:

(shënoni numrin)

viii. formulimi i politikave monetare dhe fiskale të shtetit:

(shënoni numrin)

ix. barazia e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor:

(shënoni numrin)

x. këshillimi dhe diskutimi paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike:

(shënoni numrin)

xi. mbarëvajtja e marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare:

(shënoni numrin)

xii. nëse ka arsye tjetër, specifikoni:

12. Referuar regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve, shënoni numrin e kërkesave që kanë marrë përgjigje brenda 3 ditë (pune).

(shënoni numrin)

13. Për aq sa mund të identifikoni, sa kërkesa për informacion publik kanë mbërritur pranë autoritetit publik nga:

i. qytetarë:

(shënoni numrin)

ii.gazetarë:

(shënimi numrin)

iii.përfaqësues të shoqërisë civile:

(shënimi numrin)

14. Autoriteti publik është palë në procese gjyqësore në lidhje me çështje të të drejtës për informim?

Po ☐

Jo ☐

15. Nëse po, sa procese gjyqësore ka ndjekur gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 në lidhje me çështjet e të drejtës për informim?

a.total:

(shënimi numrin)

a1.si paditës:

(shënimi numrin)

a2.i paditur:

(shënimi numrin)

a3.palë e tretë:

(shënoni numrin)

16. A ka ndonjë temë/çështje për të cilën do të dëshironit që Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të japë informacion, orientim apo udhëzim?

Emër/mbiemër i titullarit të autoritetit publik_____

Nënshkrimi/vula_____

Data_____